



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKOMBIN

VENDIM

Nr.3, datë 24.05.2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK NËPËRMJET “HEC
BUSHTRICA 1” SHOQËRISË “ELENERGJI” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “Elenergji”, sipas kontratës së koncesionit të formës “BOT”, për ndërtimin e hidrocentralit “Bushtrica 1” me nr.2025, Rep. Nr.925/2 Kol hyrë në fuqi më date 14.9.2017, si dhe Amendimi Kontratës me nr. 1643 Rep.Nr. 1045/2 të lidhur midis Ministrinë së Energjisë dhe Industrisë dhe subjektit “Elenergji” sh.p.k.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC Bushtrica 1

Lumi Bushtrica

- Fuqia e instaluar: 5226 kw

Vendndodhja e veprës së marrjes 1.

- X=540037.04; Y=4553746.02; Z=498 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja mesatare vjetore: 4.05 m³/s
- Prurja llogaritëse: 5.7 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.48 m³/s

Vendndodhja e godinës së Centralit.

- X=537079.74; Y=4551550.37; Z=380 m.m.n.d. (KRGJSH)
- 3. Zbatimi i kontratës koncesionare nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
- 4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETAR I KBU SHKUMBIN

